

Gjyqtare Rezarta Schuetz (Gaba)

Znj. Gaba-Schuetz është gjyqtare pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Gjykata Kushtetuese. Përpara se të emërohej në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, znj. Gaba-Schuetz ka punuar për 15 vjet në organizata ndërkombëtare – OKB dhe OSBE – si këshilltare ligjore dhe shefe e Seksionit të Shtetit të së Drejtës (respektivisht). Në këto funksione, ajo ka punuar në të drejtë penale (krime ndëretnike dhe krime të tjera të rënda) në të gjitha instancat. Si shefe e Seksionit për Shtetin e së Drejtës, znj. Gaba-Schuetz ka udhëhequr monitorimin dhe ka raportuar mbi respektimin e të drejtave procedurale të palëve në çështje gjyqësore të profilit të lartë, ka monitoruar zbatimin e standardeve dhe ka zbatuar reformën në procedurën penale, risitë në politikat e dënimit penal dhe zbatimin e standardeve të vendosura nga GJEDNJ-ja, si dhe ka punuar me institucionet vendase për zbatimin e reformave në fushën e pavarësisë së gjyqësorit dhe prokurorisë dhe të sistemit të llogaridhënies.

Po ashtu, znj. Gaba-Schuetz ka punuar gjerësisht në disa aspekte të të drejtave të njeriut, konceptet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të ndihmës juridike dhe standardet e qeverisjes së mirë. Më parë, si këshilltare në Dhomën e Avokatisë Amerikane dhe pedagoge e jashtme e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës në vitet 1998-2000, znj. Gaba-Schuetz ka punuar me reformën në arsimin juridik dhe ka dhënë lëndët “Etikë ligjore”, “E drejta kushtetuese e krahasuar” dhe “Shkrim e arsytim ligjor”.

Në vitet 1993-1996, si juriste e qeverisjes qendrore, ndër të tjera, znj. Gaba-Schuetz ka punuar me hartim legjislacioni në fushën e reformave të pronës bujqësore dhe industrisë ushqimore dhe ka përfaqësuar Republikën e Shqipërisë në gjykata të huaja dhe arbitrazh ndërkombëtar në mosmarrëveshje që lidheshin me investimet e huaja.

Gjyqtarja Gaba-Schuetz është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 1992 dhe më pas, në vitet 1996-1997 ka kryer Master në Institucionet Ligjore (LL.M.) në Universitetin e Wisconsin-it (SHBA), Madison.